

I. Shpalljen e funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

II. Kandidatët që aplikojnë për pozicionet civile duhet të plotësojnë kriteret bazë të mëposhtme:

- **Kritere e domosdoshme për përzgjedhjen e aplikantit**

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

c) të mos ketë marrë masën disiplinore përjashtim nga Agjencia, nga strukturat e tjera ligjzbatuese dhe të sigurisë kombëtare, ose të jetë larguar nga shërbimi civil dhe administrata shtetërore;

ç) të jetë i aftë nga ana shëndetësore, e vërtetuar me vendim të Komisionit Mjeko-Ligjor;

d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në shkencat juridike, ekonomike, informatike ose institucionet arsimore të sigurisë;

dh) të plotësojë kushtet e kriteret për t'u pajisur me Çertifikate të Sigurimit të Personelit;

e) të plotësojë kriterin e eksperiencës në punë sipas pozicionit për të cilin është shpallur vendi i lirë, si vijon:

i) të plotësojë kriterin e eksperiencës në punë sipas pozicionit për të cilin është shpallur vendi i lirë, si vijon:

i.për pozicione pune të nivelit ekzekutiv, aplikantët duhet të kenë eksperiencë pune jo më pak së 2 vjet në struktura të cilat gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore apo struktura të administratës publike;

- **Kritere të veçanta:**

a. Të ketë aftësi të mira analitike në njohjen e sistemeve kompjuterike;

b. Të njohë kuadrin ligjor që normon veprimtarinë administrative, dhe kryesisht hetimin administrativ;

c. Të ketë aftësi të mira vlerësuese dhe gjykuese;

d. Të ketë aftësi shkrimi dhe arsyetimi ligjor;

e. Të ketë aftësi organizative të punës në grup;

- **Procedurat e aplikimit**

a. Aplikanti plotëson formularin standard të aplikimit të hedhur në faqen zyrtare të AMP-së

b. Bashkëngjit dokumentacionin për aplikim dhe i dorëzon në zyrat postare të qarkut, rrethit, qytetit ose i dorëzon dorazi në zyrën e informacionit të Agjencisë në godinën e saj, në adresën: Rruga Asim Vokshi, nr.19/1, Tiranë

- **Afati për fillimin e përfundimit të i aplikimit**

a. Fillon me datë 07.11.2024 deri me datë 15.11.2024. Pas kësaj date nuk pranohen aplikime

- **Dokumentacioni që kërkohet për aplikim**

Për aplikim për punonjës të Agjencisë, aplikantët duhet të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e plotësuar të aplikimit;

b) fotokopje të kartës së identitetit;

c) kopje origjinale ose fotokopje të noterizuar të cikleve të studimit, e shoqëruar me listë notash;

- ç) certifikate të gjendjes gjyqësore;
- d) 2 foto me përmasa 4 x 6 cm;
- dh) vërtetim nga përmbartimi gjyqësor, prokuroria, dhe gjykata që nuk janë në ndjekje penale;
- e) raport mjeko ligjor mbi gjendjen shëndetësore;
- ë) dokument për vërtetimin e përvojës në punë;
- f) vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata shtetërore.

- **Fazat e pranimit**

- a) testimi me shkrim;
- b) intervistës me gojë;
- c) kontrollit shëndetësor;
- ç) verifikimit përfundimtar të aplikantit.

- **Vlerësimi i kandidatëve në procesin e testimi**

- a. Aplikanti i nënshtrohet procedurave të kontrollit të dokumentacionit të aplikimit nëse janë në përputhje me listën e dokumentave të shpallura për aplikim.
- b. Aplikantët të cilët plotësojnë kriteret bazuar dokumentacionit të kërkuar kualifikohet në fazën e testimi me shkrim.
- c. Aplikantët të cilët në testimin me shkrim arrijnë 70 pikë e më shumë kalojnë në intervistës më gojë.
- d. Rezultati i testimi me shkrim, përbën 60% të rezultatit të përgjithshëm të konkurrimit.
- e. Intervista me goje përbën 30% në rezultatit të përgjithshëm të konkurrimit.
- f. Vlerësimi i dosjes së aplikantit (niveli shkollimit, trajnimeve dhe përvojës në punë, përbën 10% në rezultatit të përgjithshëm të konkurrimit)

III. Korpusi ligjor ku duhet të referohet aplikanti.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar
- Kodi Penal, në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
- Kodi i Procedurës Penale, në Republikën e Shqipërisë
- Kodi Civil, në Republikën e Shqipërisë
- Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë
- Ligji 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- VKM Nr. 532, datë 29.07.2022 Për miratimin e Rregullores “Për funksionimin e së Agjencisë e Mbikëqyrjes Policore”

IV. Funkcionet e shpallura për konkurrim janë:

- a. Specialist Hetimi/Ankesash, në Sektorin e Hetimit dhe Ankesat nr.2, në Drejtorinë Rajonale Tiranë, në AMP, 1 (një) pozicion.
- b. Specialist Hetimi/Ankesash, në Sektorin e Hetimit dhe Ankesat Vlorë , në Drejtorinë Rajonale Vlorë- Gjirokastrë, në AMP, 1 (një) pozicion.
- c. Specialist Hetimi/Ankesash, në Sektorin e Hetimit dhe Ankesat Vlorë (Zona Sarandë), në Drejtorinë Rajonale Vlorë- Gjirokastrë, në AMP, 1 (një) pozicion.
- d. Specialist Hetimi/Ankesash, në Sektorin e Hetimit dhe Ankesat Durrës, në Drejtorinë Rajonale Durrës- Kavajë, në AMP, 1 (një) pozicion.